

TAKIMI I TRETË 2024 - KOMITETI SEKTORIAL I MIKPRITJES DHE TURIZMIT

Mbledhja e tretë e Komitetit Sektorial të Mikpritjes dhe Turizmit u mbajt më datë **25.09.2024**.

Mbledhja u përqendrua në diskutimin mbi gjetjet e Studimit të Nevojave për Aftësi (SNA) lidhur me aftësitë e kërkuara dhe/ose të munguara në tregun e punës në fushën e “Hoteleri - Turizmit”.

Sekretariati Teknik shpjegoi se, nga gjetjet e SNA-së, rezultojnë disa profesione me mungesë aftësish ose mungesë numrash, si: **“Kamarier”, “Banakier”, “Punonjës pastrimi”, “Shef dhe Asistent shef kuzhine”, “Receptionist”, “Picajol”, “Punonjës fast food-i”, “Korrier”,** etj. Gjithashtu, Sekretariati Teknik theksoi se, nga gjetjet evidentoheshin llojet e aktiviteteve, konkretisht shërbimeve që kishin mungesë aftësish apo kapacitetesh si p.sh.: përgatitja e pijeve, përgatitja e ushqimit, akomodimi, planifikimi i eventeve etj.

Anëtarët gjatë diskutimeve konfirmuan gjetjet e SNA-së, për një mungesë të dukshme të **“Punonjësve të pastrimit”, “Kamarierëve”, “Banakierëve” dhe “Kuzhinierëve”** për shkak se kishte rrjedhje të forcës punëtore gjatë periudhës së sezonit turistik.

Në vijim, u prezantua sërish oferta ekzistuese e kualifikimeve profesionale, me qëllim krahasimin e saj me gjetjet e SNA-së për nevojat e tregut të punës. Sekretariati Teknik evidentoi se, pjesa më e madhe e nevojave të identifikuar nga SNA-ja mbuloheshin nga oferta ekzistuese e kualifikimeve profesionale.

Nisur nga gjetjet, anëtarët propozuan që mund të merrej në konsideratë të ofrohej një kualifikim pas i mesëm për **“Menaxher i mesëm në operator turistik”**. Gjithashtu anëtarët diskutuan për profesionin **“Shef salle”** ose **“Menaxher i mesëm në restorant”**, i cili rezultonte si nevojë nga SNA-ja. Anëtarët argumentuan se, aftësitë për këtë rol mbuloheshin nga kualifikimet ekzistuese dhe nga përvoja praktike, ndaj një kualifikim i veçantë nuk do të ishte i nevojshëm. Nisur nga kjo dhe nga mungesa e numrave në treg u propozua që të ofrohej një kualifikim pas i mesëm për: **“Shërbim ushqimi dhe pije”**, i cili do të mbulonte edhe njohuritë e nevojshme për shefin e sallës.

Një tjetër nevojë e identifikuar nga SNA-ja lidhej me **“Menaxher/Organizator eventesh”**. U propozua mundësia e ofrimit të një kursi të unifikuar ose të një kualifikimi pas të mesëm, por u la të diskutohej mbledhjen e ardhshme për vendimmarrje.

Pas diskutimeve me detaje të gjetjeve të SNA-së, anëtarët dolën në konkluzionin se mungesat që dilnin ishin në shumicën e rasteve mungesë numrash, jo mungesë kualifikimesh profesionale, që vinin si rezultat i numrit të ulët të nxënësve në arsim dhe formim profesional, krahasuar me kërkesën e lartë të tregut. Nisur nga kjo, anëtarët propozuan që mund të përmirësohej oferta e kualifikimeve afatshkurtra për profesione të caktuara.

Sekretariati Teknik shpjegoi se, Programet e Kurseve të Unifikuara përgatiteshin nga AKAFPK dhe në të ardhmen do të integroheshin në Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve, ndërsa kurset me bazë qendre përgatiteshin nga vetë qendrat në bazë të kërkesave dhe nevojave lokale. Sekretariati Teknik informoi se, oferta ekzistuese e kurseve reflektonte nevojat e evidentuara nga SNA-ja, si: **“Receptionist”**, **“Punonjës pastrimi”**, **“Shërbime në bujtina”** dhe **“Operator turistik”**. Nisur nga kjo, anëtarët propozuan që të ofrohej një kurs i unifikuar për: **“Picajol”**.

Në pjesën e fundit të takimit Sekretariati Teknik informoi anëtarët se, Shkolla “Hoteleri - Turizëm”, Tiranë, kishte lidhur një marrëveshje me “Ecole Hôtelière de Lausanne (EHL)”. Sekretariati Teknik sqaroi se, shkolla ofronte tre profile (tre vjeçare bllok) për: **“Kuzhinë”**, **“Hotel”** dhe **“Shërbim Ushqimi dhe Pije”**. Mësimi do të zhvillohej në gjuhën angleze dhe certifikatat e përfituara në përfundim të kualifikimit do të njiheshin nga EHL. Gjithashtu, u bë me dije se, nxënësit e këtij programi do të ishin të parët që do të përfitonin Maturën Shkollore Profesionale. Gjithashtu, Sekretariati Teknik informoi se, shkollat e “Hoteleri - Turizmit” kishin mundësi të ofronin një kualifikim pas të mesëm një vjeçar, që ishte propozuar nga Komiteti, për **“Menaxher të strukturave akomoduese”**, i cili do të ofrohej me sistemin dual, sistem që po aplikohet për herë të parë në Shqipëri.

Vendime të marra nga mbledhja:

- Të ofrohej një kualifikim pas i mesëm (një ose dy vjeçar) për **“Menaxher i mesëm në operator turistik”**.
- Të ofrohej një kurs i unifikuar për: **“Picajol”**.
- Të ofrohej një kualifikim pas i mesëm për **“Shërbim ushqimi dhe pije”**.